



Pranuar / Dorezuar Prijmljeno/Prudato Received/Delivered	30.12.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org /Unit	Hr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPUSHAK	8701/2022		1/5



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1046/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në çështjen juridike “masë disiplinore”, sipas ankesës me numër A.nr.1046/2022 të datës 23.11.2022, të parashtruar nga ankuesja _____ nga _____ duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 30.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Shfuqizohet Vendimi me numër protokollit 02-016-130466 i datës 08.11.2022 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjilanit dhe *çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë.*

II. Obligohet Komisioni Disiplinor i Komunës së Gjilanit që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore për zbatimin e këtij vendimit ashtu siç është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja _____ e punësuar në Komunën e Gjilanit më datë 23.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7338/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e plotësuar me datë 07.12.2022, kundër Vendimit me numër protokollit 02-016-130466 të datës 08.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjilanit, me pretendimet për shkelje procedurale dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.12.2022 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë tek Komuna e Gjilanit. Ndërsa Këshilli më datë 13.12.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 7338/2022 të datës 23.11.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokoll 02-016-130466 të datës 08.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjilanit; Plotësimin e ankesës më datë 07.12.2022 me numër protokoll 7725/2022; Aktvendimin me numër reference: 10-942-91363-2022 i Zyrës Kadastrale të Komunës së Gjilanit; Vendimin me numër 01 Nr.016-59966 i datës 26.05.2022 i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit; Aktvendimin me numër reference: 10-942-131504-2022 i datës 07.12.2022 për pezullimin e përkohshëm të procedurës; Kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore me numër protokoll 02-1079 e datës 11.10.2022; Procesverbal i Komisionit Disiplinor i datës 20.10.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokoll 7517/2022 e datës 01.12.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokoll 8000/2022 e datës 13.12.2022; Akt Emërimit me numër protokoll 01-16-19967 i datës 22.07.2011 për ankuesen; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesen i datës 28.01.2022; Vendimin me numër protokoll 02-111 i datës 20.02.2020 për pushim të lehonisë për ankuesen; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 04.11.2022; Njoftimin me numër protokoll 02-016-120645 të datës 12.10.2022; Ftesë për shqyrtim kryesor me numër protokoll 02-016-122476 e datës 18.10.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të Komisioni Disiplinor të Komunës së Gjilanit, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rezulton së ankuesja është e punësuar në Komunën e Gjilanit dhe së e njëjta sipas Akt-it të Emërimit me numër protokoll 02-16-19967 të datës 22.07.2011 është emëruar dhe ushtron pozitën e punës me titull *Inxhinieri e Gjeodezisë* në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

Me tej bazuar në shkresat e lëndës rrjedh së Drejtori i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Gjilanit, më datë 11.10.2022 ka parashtruar kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses, mbi bazën se ankuesja ka bërë shkelje të rëndë disiplinore në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse e njëjta ka refuzuar të aprovoj kërkesën me numër protokoll 10-942-91365 lidhur me modifikimin e attributeve të parcelës me numër P-70403013-01432-29 e evidentuar në pronësi të personave me inicialet E.Sh dhe I.Sh.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Gjilanit me Vendimin me numër protokoll 02-016-130466 të datës 08.11.2022 ka shpallur përgjegjëse ankuesen për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik lidhur me nenin 5 paragrafi

1 nënparagrafi 1.1 të Rregullores (QRK) nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, duke i shqiptuar masën disiplinore *“ndalim i 20% të pagës mujore për periudhën një (1) mujore”*.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pretendon se refuzimi i kërkesës me numër protokolli 10-942-91365-2022 të datës 20.07.2022 lidhur me ndryshimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore është bërë për faktin së ndryshimi i kulturës nga arë në tokë ndërtimore behët vetëm më vendim të organit kompetent të urbanizmit e jo vendimi të Drejtorisë së Bujqërisë ndërsa vendimi i Drejtorisë së Bujqësisë shërben vetëm për ndryshim të destinimit, sepse ndryshimi i destinimit behët me plane urbanistike respektivisht Planin Zhvillimor Komunal, rrjedhimisht pronari duhej të bënte parcelimin e pronës në fjalë e pastaj të lëshohen kushte ndërtimore dhe leja e ndërtimit dhe së kërkesa për destinim duhet të behej tek gjeodeti apo kompania gjeodete. Me tej, ankuesja thekson së në përbërje të Komisionit Disiplinor nuk ka asnjë nëpunës të Njesisë së Burimeve Njerëzore dhe kryetari i Komisionit ka qenë në konflikt interesi pasi që është shok me babain e Drejtorit për Gjeodezi në kuadër të Komunës së Gjilanit.

Lidhur me shqyrtimin e themelësisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkitazi me rregullimin e procedurës dhe përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil, gjegjësisht Kolegji analizoj:

Nenin 45 më të cilin është përcaktuar se: *“Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. “ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;” 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit”*.

Nenin 46, i cili trajton shkeljet disiplinore ku përcakton se: *“shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta, Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasojë të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i delhur në punë”*.

Nenin 47 paragrafi 1 më të cilin është përcaktuar se: *“Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjastë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”*.

Nenin 48 i cili ka përcaktuar se: *"1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 3. Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor"*.

Bazuar në kuadrin ligjor si me sipër, Kolegji ka analizuar vendimin e kundërshtuar me ankesë gjegjësisht Vendimin me numër protokolli 02-016-130466 të datës 08.11.2022 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjilanit dhe si rrjedhojë ka konstatuar së arsyetimi i vendimit të kundërshtuar më ankesë është i mangët dhe i pamjaftueshëm, pasi që i njëjti nuk përmban sqarim lidhur me faktet vendimtare që kanë sjell nxjerrën e vendimit gjegjësisht shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuesit, bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve, kështu që duke u bazuar në nenin 48 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtshënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij. Rrjedhimisht, Komisioni Disiplinor në arsyetimin e vendimit të goditur me ankesë ka cituar vetëm deklaratën e ankueses dhe sqarimin e shkresës së Agjencisë Kadastrave të Kosovës, duke mos specifikuar faktet relevant mbi bazën e të cilave Komisioni Disiplinor ka vërtetuar së ankuesja ka bërë shkelje të rëndë disiplinore.

Ndërlidhur si me lart, Kolegji po nga vlerësimi i vendimit të kundërshtuar me ankesë ka gjetur së Komisioni Disiplinor me rastin e vendosjes kishte dështuar të vlerësoj drejtë shkresën e datës 07.10.2022 të Agjencisë Kadastrale të Kosovës për dhënie të mendimit ligjore, sipas të cilës shkresë është rekomanduar nder të tjerash që pala duhej të sqarohej me Drejtorinë e Urbanizimit të Komunës së Gjilanit përkitazi me specifikimin e sipërfaqes prej 127 m² në parcelën me numër 1432-29.

Me dispozitat e nenit 26 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë është përcaktuar se: *"Nëse zyrtari publik dyshon për paligjshmërinë e urdhrin të mbikëqyrësit, ai nuk e zbaton urdhrin, por informon pa vonesë mbikëqyrësin e personit që ka dhënë urdhrin dhe kërkon konfirmimin me shkrim nga ana e mbikëqyrësit"*, andaj, Komisioni Disiplinor në ri procedurë duhet të marr parasysh këto dispozita ligjore, rrjedhimisht në vlerësimin e Kolegjit në çdo rast kur nëpunësi civil refuzon përmbushjen e një detyre për shkak të dyshimit në ligjshmërinë e ekzekutimit, është përgjegjësi e mbikëqyrësit të nëpunësit civil në fjalë që të konfirmoj ligjshmërinë apo jo ligjshmërinë, ndërsa në rastin konkret me asnjë dëshmi nuk vërtetohet së mbikëqyrësi i ankueses ka dhënë konfirmim lidhur me ligjshmërinë e kërkesës së refuzuar.

Përkitazi me perëndimet ankimor të ankueses se në përbëje të Komisionit Disiplinor, nuk ka zyrtar nga njësia e Burimeve Njerëzore si dhe ka pas konflikt interesi në raport mes të Kryesuesit të Komisionit Disiplinor dhe iniciuesit të procedurës disiplinore pra në këtë rast Drejtorit të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Gjilanit, Kolegji i Këshillit në mungesë të dëshmimeve nuk ka mundur të provoj bazushemerinë e këtyre pretendimeve ankimore.

Andaj, duke qenë së vendimi i konstatuar, gjegjësisht Vendimi më numër protokolli -016-130466 të datës 08.11.2022 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjilanit, përmban të meta të tilla të cilat pamundësojnë vendosjen meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit vendosi që kjo çështja ankimore të kthehet në ri-shqyrtim dhe rivendosje tek organi kompetent, në këtë rast të Komisioni Disiplinor i Komunës së Gjilanit, me detyrimin që i njëjti të

merr parasysh pikëpamjet juridike të dhëna nga Kolegji i Këshillit si dhe të nxjerrë vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë.


Përmbledhur si me sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.


Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1046/2022

Avdyll BEKTESHI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Komisionit Disiplinor të Komunës së Gjilanit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjilanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;